

Dokumenti i shkurtër për politika publike nr. 36/2021


-

Investimi i ri amerikan në luftën kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut

Sara Janeska

-

nëntor 2021



Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Nacional për Demokraci të SHBA-ve dhe Institutit Societas Civilis për Demokraci - Shkup

Impresum

Titull: Investimi i ri amerikan në luftën kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut

Botues: Instituti për Demokraci
"Societas Civilis" - Shkup

Autor: Sara Janeska

Përkthimi: Vjosa Taipi

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.idscs.org.mk>

Maqedonia e Veriut ka vite që po përballlet me korrupsion të përhapur gjerësisht dhe sfida serioze në sundimin e ligjit. Institucionet jofunksionale, stagnimi në zhvillimin ekonomik dhe pabarazia sociale janë kryesisht për shkak të përpjekjeve të kufizuara për zbatimin e reformave kundër korrupsionit, sundimit të ligjit dhe mungesës së konsensusit politik në këtë betejë. Prandaj, lufta kundër korrupsionit është gjithnjë e më e rëndësishme për qytetarët dhe njihet si prioritet kryesor për demokratizimin dhe parakusht për integrimin evropian të vendit. Në vendet në zhvillim si Maqedonia e Veriut, bashkëpunimi bilateral dhe mbështetja nga partnerët strategjikë janë vendimtare për luftë efektive kundër korrupsionit. Aktor kryesor këtu janë SHBA-të, që mbështesin këto procese përmes asistencës politike, financiare dhe administrative.

Që nga vendosja e marrëdhënieve dypalëshe në vitin 1995, SHBA-të, në Maqedoninë e Veriut kanë mbështetur, ndër të tjera, forcimin e institucioneve demokratike, sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit dhe diskriminimit. Këtë vit, presidenti i sapo-zgjedhur i SHBA-vë, Joe Biden dhe administrata e tij e kanë ngritur luftën kundër korrupsionit ndër prioritetet kryesore të politikës së tyre ndaj Maqedonisë së Veriut dhe Ballkanit Perëndimor. Qeveria e SHBA-ve, ka nxjerrë disa vendime dhe raporte ku theksohet ndikimi negativ i korrupsionit në shumicën e parametrave të zhvillimit ekonomik dhe social në vend dhe parashikojnë hapa konkretë për adresimin e problemit. Gjithashtu, lufta kundër korrupsionit do të jetë një nga shtyllat kryesore të Samitit të Demokracive, nismë e Presidentit Joe Biden, në të cilin do të marrë pjesë edhe vendi ynë. Fokusi i zmadhuar në këto tema shënon gjithashtu një dinamikë të re në marrëdhëniet e SHBA-së me të gjitha institucionet, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare në vend që punojnë për të luftuar korrupsionin, si dhe pritshmëri të caktuara nga performanca e tyre.

Ky dokument i shkurtë për politika publike ofron përmbledhje të politikave të reja ndërkombëtare të SHBA-së, për përballje me korrupsionin dhe ndikimi i tyre mbi përpjekjet maqedonase kundër korrupsionit dhe institucionet.

Fokusi i politikës ndërkombëtare të SHBA-ve, në luftën kundër korrupsionit

Presidenti i ri i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden u zgjodh në fund të vitit 2020. Pas marrjes së detyrës në janar 2021, Presidenti mori disa vendime që e vendosin luftën kundër korrupsionit në fokusin e politikës së tyre ndaj Maqedonisë së Veriut dhe Ballkanit Perëndimor.

Në qershor 2021, qeveria e SHBA-ve miratoi Memorandumin¹ që përcakton luftën kundër korrupsionit si një shqetësim kryesor i sigurisë kombëtare dhe thekson se institucionet do të punojnë për të promovuar qeverisjen e mirë, transparencën dhe parandalimin e korrupsionit në SHBA dhe jashtë saj. Nëpërmjet Memorandumit, qeveria e SHBA-së, merr përsipër të ndërmarrë një sërë veprimesh për të forcuar kapacitetet e institucioneve vendase dhe ndërkombëtare që punojnë në tema që kanë të bëjnë me kthimin e pronave, vendosjen e normave globale kundër korrupsionit, promovimin e transparencës financiare, parandalimin e pastrimit të parave dhe të ngjashme. SHBA-të, do të shtojnë gjithashtu përpjekjet për të rritur burimet për ndihmën hetimore, financiare, teknike dhe politike për shtetet që demonstrojnë vullnetin dhe përpjekjet për të reduktuar korrupsionin. Memorandumi parashikon gjithashtu thirrjen për përgjegjësi të personave të korruptuar dhe identifikimin, ngrirjen dhe kthimin e pasurive të vjedhura.

Pezullimi i pronës së personave janë përfshirë në veprime korruptive, është përfshirë në Vendimin ekzekutiv² të Presidentit të SHBA-ve, për Ballkanin Perëndimor, i miratuar në qershor 2021, i cili lejon qeverisë amerikane të sanksionojë të gjithë personat që kontribuojnë në destabilizimin e rajonit. Sanksionet përfshijnë ndalimin e hyrjes dhe bllokimin e pronave të atyre që kërcënojnë institucionet demokratike, sigurinë, integritetin territorial dhe zbatimin e

¹ Memorandum on Establishing the Fight Against Corruption as a Core United States National Interest. The White House, Presidential Actions, qershor 2021. Në dispozicion në: <<https://www.whitehouse.gov/briefing-room/presidential-actions/2021/06/03/memorandum-on-establishing-the-fight-against-corruption-as-a-core-united-states-national-security-interest/>>

² Executive Order on Blocking Property And Suspending Entry Into The United States Of Certain Persons Contributing To The Destabilizing Situation In The Western Balkans. The White House, Presidential Actions, qershor 2021. Në dispozicion në: <<https://www.whitehouse.gov/briefing-room/presidential-actions/2021/06/08/executive-order-on-blocking-property-and-suspending-entry-into-the-united-states-of-certain-persons-contributing-to-the-destabilizing-situation-in-the-western-balkans/>>

marrëveshjeve paqësore në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Marrëveshjen e Prespës. Vendimi targeton edhe të gjithë personat e akuzuar për raste të rënda të korrupsionit dhe ryshfetit në rajon, duke përfshirë rastet që përfshijnë funksionarët aktualë ose ish funksionarët në çdo nivel të pushtetit.

Baza për këtë vendim është akti global "Magnitsky" përmes të cilit qeveria e SHBA-ve, mund të vendosë sanksione ndaj individëve nga cili do vend, fajtorë për shkelje të të drejtave të njeriut dhe veprime korruptive. Përveç SHBA-ve, Akti Global "Magnitsky" u miratua nga parlamentet në shumicën e vendeve, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar, Kanadanë, Estoninë dhe Lituanië, dhe në dhjetor 2020, Akti u miratua nga Parlamenti Evropian.

Kohët e fundit, në rajon, SHBA-të, vendosën sanksione bazuar në aktin për tre funksionarë bullgarë të akuzuar për keqpërdorim me institucionet publike për përfitime personale. Sanksionet ndërpresin qasjen në sistemin financiar të SHBA-ve, për ish-deputet të parlamentit bullgar, biznesmen dhe zëvendës drejtor të një institucioni publik, si dhe kompanitë dhe organizatat me të cilat ata janë të lidhur. Pas vendosjes së sanksioneve nga SHBA-të, qeveria bullgare i vendosi në listën e zezë këta individë dhe të gjithë ata që lidhen me ta dhe njoftoi ndalimin e bashkëpunimit të autoriteteve lokale dhe kombëtare me ta.

Hapat konkretë për Maqedoninë e Veriut

—

Reduktimi i korrupsionit është gjithashtu një nga tre prioritetet kryesore të Strategjisë për Zhvillimin të Maqedonisë së Veriut për vitin 2020 - 2025 të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA-ve (USAID).³ Strategjia njuh korrupsionin si problem qendror që pamundëson kohezionin social, minon besueshmërinë e partive politike, institucioneve publike dhe sundimin e ligjit. Qëllimi strategjik për reduktimin e korrupsionit parashikon mbi ndërtimin e investimeve të mëparshme në kapacitetet e shoqërisë civile dhe qeverisë me qëllim rritjen e fokusit ndaj korrupsionit. Strategjia do të mbështesë përpjekjet për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së partive politike, si segment kryesor për shënjestrimin e ndikimeve malinje në shoqëri, si dhe përpjekjet lokale për forcimin e mekanizmave për transparencë dhe llogaridhënie.

Gjatë realizimit të prioritetëve, Strategjia thekson se do të mundësohen partneritete të udhëhequra nga shtetet me sektorin privat dhe shoqërinë civile. Në shtator të këtij viti, Qeveria e SHBA-së përmes USAID-it e rriti grantin nga 8,2 milionë dollarë në 56,6 milionë dollarë për arritjen e qëllimeve të Strategjisë, përkatësisht, forcimin e konkurrencës ekonomike, rritjen e kontributit të të rinjve në shoqëri dhe luftimin e korrupsionit.⁴ Nga këto mjete, 50% do të investohet për arritjen e objektivit strategjik për uljen e korrupsionit.

Korrupsioni përmendet gjithashtu si një nga barrierat kryesore për investim të kompanive amerikane në Maqedoninë e Veriut në Raportin për Klimën e Investimeve të Departamentit të shtetit.⁵ Sipas raportit, klima e pasigurt e biznesit në vend, kryesisht më shumë i referohet

³ Country Development Cooperation Strategy, 2020-2025. USAID/North Macedonia, shtator 2020. Në dispozicion në: https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/CDCS_North_Macedonia_External_2025.pdf

⁴ Qeveria: Shtetet e Bashkuara kanë rritur vlerën e grantit të partneritetit me Maqedoninë e Veriut nga 8,2 milionë dollarë në 56,6 milionë dollarë. Nova TV, shtator 2021. Në dispozicion në: <https://novatv.mk/vlada-sad-ja-zgolemija-vrednosta-na-grantot-za-partnerstvo-so-severna-makedonija-od-8-2-milioni-na-56-6-milioni-dolari/>

⁵ 2021 Investment Climate Statements: North Macedonia. U.S. Department of State, korrik 2021. Në dispozicion në: <https://www.state.gov/reports/2021-investment-climate-statements/north-macedonia/>

korrupsionit të lartë, ndryshimeve të shpeshta ligjore dhe rregullative dhe interpretimit dhe zbatimit jokonsistent të tyre. Korrupsioni dhe ryshfeti janë të pranishme në prokurimet publike ndërkaq ekzistojnë akuza për korrupsion në administratë. Raporti thekson se problemi që duhet të adresohet është ndryshimi i shpeshtë i ligjeve dhe rregullativës dhe zbatimi i ngadaltë i rregullave dhe implementimi i ligjeve të reja.

Gjetjet e Raportit për klimën e investimeve, janë cituar disa herë nga partitë opozitare, gjatë çka janë theksuar keqpërdorime të procedurave të shkurtuara në Kuvend dhe korrupsionin e lartë në mesin e nëpunësve qeveritarë.⁶ Nga ana tjetër, kryeministri Zaev ka dhënë deklaratë për gjetjet e raportit se korrupsioni është konstatuar në funksionimin administrativ të institucioneve publike, e jo në mesin e ministrave dhe funksionarëve. Kryeministri shtoi gjithashtu se gjetjet e raportit do të përdoren për të përmirësuar luftën kundër korrupsionit.⁷

Ambasada e SHBA-së në Maqedoninë e Veriut do të punojë edhe për çrrënjosjen e korrupsionit në proceset administrative, përmes një projekti për digjitalizimin e shërbimeve administrative të cilin e zbaton së bashku me Qendrën Estoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Sekretariatit për Çështje Evropiane. Projekti do të ofrojë mbështetje teknike për zhvillimin e Maqedonisë së Veriut dhe promovimin e qeverisjes së mirë dhe rritjen ekonomike përmes proceseve të digjitalizimit. Ndër të tjera, projekti pritet të ofrojë bazë për bashkëpunim ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Estonisë në sektorë të tjerë vendimtarë për zhvillimin e vendit, siç janë shoqëria civile, sektori privat dhe të rinjtë.⁸

⁶ VMRO-DPMNE dhe AA: Departamenti i Shtetit ka konfirmuar se korrupsioni është problem kryesor. Radio Evropa e Lirë, korrik 2021. Në dispozicion në: <<https://www.slobodnaevropa.mk/a/31375258.html>>

⁷ Nëpunësit janë vatër korrupsioni, jo ministrat: Kryeministri Zaev për raportin e Departamentit të Shtetit. Faktor, korrik 2021. Në dispozicion në: <<https://faktor.mk/sluzbenicite-se-leglo-na-korupcija-ne-ministrite-premierot-zaev-za-izveshtajot-na-stejt-departmentot>>

⁸ Me Estoninë do t'ju ndihmojmë të hyni në BE sepse një Maqedoni stabile është interes gjeostrategjik amerikan, thonë nga Ambasada e SHBA-ve. Dua Të Them, shtator, 2021. Në dispozicion në: <<https://sdk.mk/index.php/instagram/so-estonija-ke-vi-pomagame-da-vlezete-vo-eu-zatoa-shto-stabilna-makedonija-e-amerikanski-geostrateshki-interes-velat-od-ambasadata-na-sad/>>

Çfarë më tutje?

Lufta kundër korrupsionit është në qendër të politikës së jashtme të administratës së re të SHBA-ve. Përpjekjet dhe investimet e shtuara në parandalimin e korrupsionit në Maqedoninë e Veriut, tregojnë se vendi njihet si partner në zgjidhjen e problemit global. Kjo do të thotë se institucionet pritet të ndërmarrin aktivitete konkrete për zgjidhjen e korrupsionit në vend. Progresi në këtë fushë është gjithashtu vendimtar për ruajtjen e perceptimit për Maqedoninë e Veriut, si partner në luftën kundër korrupsionit, dhe jo si pjesë e problemit. Qeveria dhe institucionet kundër korrupsionit duhet të kenë prioritet parandalimin e korrupsionit, me qëllim për të vazhduar partneritetin strategjik dhe mbështetjen politike, financiare dhe teknike të fituar në zhvillimin dhe demokratizimin e vendit. Prandaj, duhet të intensifikohen seriozisht aktivitetet që synojnë zbatimin e reformave kundër korrupsionit nga Qeveria dhe institucionet e tjera me kompetenca kundër korrupsionit.

Kuvendi është thelbësor për luftën kundër korrupsionit. Deputetët zgjedhin kryesinë dhe mbikëqyrin punën e institucioneve kryesore me kompetenca kundër korrupsionit, siç janë KSHPK, ESHR dhe Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës. Mbështetja e shprehur nga deputetët e qeverisë dhe opozitës ndaj masat e SHBA-së kundër korrupsionit tregon vullnetin politik dhe bazë për qasje të përbashkët drejt luftimit të korrupsionit. Hapi tjetër do të ishte që deputetët të konfirmojnë këtë mbështetje duke zbatuar aktivitete specifike brenda kompetencave të tyre për të luftuar korrupsionin. Një nga mënyrat se si mund të bëhet kjo është përmes mbajtjen e seancave dëgjimore përmbajtjesore për raportet vjetore për punën e këtyre institucioneve dhe realizimin e seancave mbikëqyrëse për luftimin e korrupsionit në fusha të caktuara të punës së tyre. Në këtë mënyrë, deputetët mund të inkurajojnë llogaridhënien dhe proaktivitetin e institucioneve kundër korrupsionit dhe të kërkojnë oferta konkrete nga puna e tyre.

Informacion mbi IDSCS

IDSCS është think tank - organizatë civile që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, shtetin e së drejtës dhe integrimin evropian të Maqedonisë. IDSCS ka për mision ndihmën e angazhimit qytetar në vendimmarrje dhe për të forcuar kulturën pjesëmarrëse politike. Duke zhvilluar vlerat liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën midis diversitetit

Informatat kontaktuese për IDSCS

Adresë: Str. Miroslav Krlezha No.52/1 /2,
1000 Shkup
Telefoni / Fax: +389 2 3094760
E-Mail: contact@idscs.org.mk

Informacione rreth projektit

Bisedimet Kundër Korrupsionit në Kuvend është projekt që synon forcimin e rolit mbikëqyrës të deputetëve në luftën kundër korrupsionit. Projekti është financuar nga Fondacioni Nacional për Demokraci në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Informacion rreth autorit

Sara Janeska është hulumtuese e re në Qendrën për Qeverisje të Mirë pranë Institutit për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Link

Ky publikim është në dispozicion në:

<https://idscs.org.mk/mk/portfolio/investimi-i-ri-amerikan-ne-luften-kunder-korrupsionit-ne-maqedonine-e-veriut/>

